

Njoftim për përqendrim me të cilin ALFI RE, menaxhim i fondeve të investimeve alternative, d.o.o. nga Sllovenia do të fitoj kontroll të pavarur mbi DCO, shoqëria për zhvillim të projekteve d.o.o. nga Sllovenia

(Lënda nr. 08-125 të vitit 2022)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 21.09.2022, në Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga ALFI RE, menaxhim i fondeve të investimeve alternative, d.o.o me seli në adresën rruga Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni, mbi shoqërinë DCO , shoqëri për zhvillim të projekteve d.o.o. me seli në Letalishka cesta 33, 1000 Lubjanë, Slloveni.

ALFI RE, menaxhim i fondeve të investimeve alternative, d.o.o. është administrues i fondeve të investimeve alternative të regjistruar në Agjencinë e Tregut të Letrave me Vlerë të Sllovenisë. ALFI RE, menaxhim i fondeve të investimeve alternative, d.o.o analizon investimet (potenciale) dhe administron fondet e investimeve, ndërsa vetë menaxhimi i investimeve transferohet pjesërisht tek shoqëri të tjera. ALFI RE, administrim i fondit alternativ të investimeve menaxhon Alfi RE, SIS, i cili u themelua me emrin ALFI RE, Fondi Special i Investimit me seli të regjistruar në rrugën Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni.

Grupi Alfi është e regjistruar dhe e pranishme në Maqedoninë e Veriut:

- PRO KOLEKT SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Hristo Tatarçev 121-G, Kisella Vodë, Shkup, kompani e specializuar në pagesën e borxheve në mënyrë jashtëgjyqësore. Aktivitetet kryesore të PRO KOLEKT SHPKNJP Shkup janë pagesa dhe blerja e kërkesave dhe
- APOLLO MK SHPKNJP Shkup, me seli në Bulevardi Kiro Gligorov nr. 13, Gazi Babë, Shkup, e cila është aktive në shitjen me shumicë të lodrave, pajisjeve cilësore për fëmijë, aksesorëve për fëmijë dhe produkteve të tekstit për fëmijë.

Alfi Group nuk është i pranishëm në tregun relevant në Maqedoninë e Veriut, ashtu siç është definuar tregu relevant më poshtë.

DCO, shoqëri për zhvillim të projekteve d.o.o. është pronar i pasurive të paluajtshme që ndodhet në Dunajska cesta 155-157, 1000 Lubjanë, Slloveni e cila ka një parcelë ndërtimi në Lubjanë, Slloveni ku është duke u ndërtuar një ndërtesë afariste e përbërë nga kati përdhes, dy (2) kate nëntokë dhe shtatë (7) kate mbi tokë. Kjo pronë do të përdoret kryesisht për përdorim zyre dhe punë komerciale.

DCO, shoqëri për zhvillim të projekteve d.o.o. nuk është e pranishme dhe aspak nuk realizon ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Tregu relevant i mallrave për përqendrimin e paraqitur mund të përkufizohet ***si tregu i menaxhimit të pasurive të paluajtshme komerciale.***

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

22.09.2022

Shkup